



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 21 mars 2016
Nr. ref.:RK1000/16

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin KI89/15

Parashtrues

Fatmir Koci

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së
Aktgjyimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PAKR. nr. 473/2014,
të 21 nëntorit 2014**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga z. Fatmir Koci nga Prizreni (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), i përfaqësuar nga znj. Flutra Hoxha, avokate nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, PAKR. Nr. 473/2014, të 21 nëntorit 2014, në lidhje me Aktgjykimin P. nr. 353/13 të Gjykatës Themelore në Prizren, të 11 korrikut 2014.
3. Aktgjykimi i fundit i kontestuar i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 23 shkurt 2015.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar PAKR. Nr. 473/2014, të Gjykatës së Apelit të Kosovës, të 21 nëntorit 2014.
5. Parashtruesi pretendon shkeljen e nenit 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 33 [Parimi i Legalitetit dhe Proporcionalitetit në Rastet Penale], 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) në lidhje me nenin 6 (1) dhe 3 (d) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: Konventa) dhe nenit 7 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: DUDNJ).

Baza juridike

6. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) dhe në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

7. Më 23 qershor 2015, parashtruesi dorëzoi me postë kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
8. Më 3 gusht 2015, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Snezhana Botusharova gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Bekim Sejdiu dhe Arta Rama-Hajrizi.
9. Më 17 shtator 2015, Gjykata njoftoi parashtruesin në lidhje me regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ai që të dorëzojë dëshmi të dorëzimit të aktgjykimit të kontestuar, si dhe parashtresat e paraqitura gjatë rrjedhës së procedurës të rregullt. Të njëjtën ditë, nga një kopje e kërkesës iu dërgua Gjykatës Themelore në Prizren dhe Gjykatës së Apelit të Kosovës.
10. Më 28 shtator 2015, parashtruesi i kërkesës përveç paraqitjes së dokumenteve të reja gjithashtu, e informoi Gjykatën, se ai e ka revokuar autorizimin e znj. Myrvete Çollaku dhe ka autorizuar znj. Flutra Hoxha për ta përfaqësuar atë në Gjykatë.

11. Më 28 janar 2016, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

12. Në një datë të pacaktuar, parashtruesi i kërkesës si person zyrtar - elektrikist i Kompanisë së Distribucionit dhe Furnizimit të Energjisë Elektrike të Kosovës (në tekstin e mëtejme: KEDS), ka kërkuar nga një individ privat X shumë prej 500€, që mos ta dërgojë orën e energjisë elektrike për testim (*kalibrim*) në zyrën e KEDS-it, në Prishtinë. Parashtruesi i kërkesës dhe X ishin pajtuar të takohen në një restorant të caktuar në Prizren për ta përmbyllur “marrëveshjen” e lartcekur.
13. Në ndërkohë, X kontaktoi Policinë e Kosovës dhe u tregoi atyre bisedën e tij me parashtruesin e kërkesës. Policia e Kosovës i dha 500 € personit X, në mënyrë që t’ia ofrojë ato parashtruesit të kërkesës.
14. Më 2 gusht 2013, parashtruesi i kërkesës dhe X u takuan në një restorant të caktuar në Prizren ku parashtruesi pranoi 500 € nga personi X. Parashtruesi i kërkesës ishte ndaluar më pas nga Policia e Kosovës, e cila gjeti sasinë e theksuar të parave në çantën e tij.
15. Më 3 gusht 2013, Prokuroria Themelore në Gjakovë ka kërkuar paraburgimin dhe vendimin për fillimin e hetimeve kundër parashtruesit të kërkesës, në bazë të veprave penale të keqpërdorimit të pozitës zyrtare ose autoritetit dhe marrjes së ryshfetit, të parapara me nenet 422 dhe 428 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: KPRK).
16. Më 3 gusht 2013, Gjykata Themelore në Gjakovë me Vendimin PPr. KR. 73/13 aprovoi kërkesën e Prokurorit Publik dhe urdhëroi një muaj paraburgim për parashtruesin e kërkesës.
17. Më 22 tetor 2013, Prokurori parashtrroi Aktakuzën PPr. Nr. 155/13 kundër parashtruesit të kërkesës në Gjykatën Themelore në Prizren - për shkak të veprës penale të marrjes së ryshfetit - sipas nenit 428, paragrafi 2, i KPRK-së. Prokurori kishte theksuar, *inter alia*, është përtej dyshimit se parashtruesi ishte një zyrtar i KEDS, dhe se ai pranoi 500 € nga X.
18. Parashtruesi deklaroi në Gjykatën Themelore, *inter alia*, se veprimet e tij nuk ishin të paligjshme për shkak se X ka deklaruar se ai nuk është i dëmtuar, se ai i mori paratë nga X për të paguar borxhin e energjisë elektrike dhe jo si ryshfet, dhe se nuk është dëshmuar se ai ka kryer veprën penale në fjalë.
19. Më 11 korrik 2014, Gjykata Themelore në Prizren me Aktgjykimin, P. nr. 353/13, shpalli parashtruesin e kërkesës fajtor duke theksuar:

“ËSHTE FAJTOR Se më datën 02.08.2013 rreth orës 13,10 minuta në Prizren, në cilësinë e personit zyrtar - elektrikist për matjen e njehsorëve pranë KEDS në Prizren, drejtpërdrejtë kërkon përfitim për vete në mënyrë që si zyrtar për matjen e njehsorëve të veprojë në kundërshtim me detyrën e tij zyrtare (të cilat rrjedhin nga kontrata e punës me nr. 12105/0 të datës

01.01.2013), për të mos dërguar njehsorin e rrymës në kalibrim në Prishtinë, e cila paraprakisht ishte marrur nga shtëpia e të dëmtuarit disa ditë më parë, në atë mënyrë që nga i dëmtuari Arsim Sadiku gjatë takimit të tyre në restorantin e marketit "Super Viva" pranon shumën prej 500 euro në apoena 10 x 50 Euro, duke i futur në çantë ashtu që në momentin e daljes nga restorani ndalohet nga Njësi i krimeve ekonomike dhe me kontrollim paraprak tek ai janë gjetur paratë të cilat i njëjti i kishte marrur e të cilat me pas janë konfiskuar.

- Kësodore ka kryer veprën penale marrja e ryshfetit nga nenin 428 par. 2 të KPK-së.

GJYKON me dënim me gjobë në shumën prej 1000/njëmijë/euro, si dhe dënim me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) vjet e 3 (tre) muaj, në të cilin dënim do t'i llogaritet edhe koha e kaluar në arrest shtëpiak prej datës 03.08.2013 e gjerë më 21.10.2013".

20. Gjykata Themelore, *inter alia*, arsyetoi se gjetjet e veta i kishte bazuar në deklaratat e të dëmtuarit X, se parashtruesi në cilësinë e personit zyrtar - elektrikist i KEDS drejtpërdrejt – ka kërkuar fitim - nga X, që parashtruesi i kërkesës pranoi 500 € nga X dhe u ndalua më pas nga Policia e Kosovës.
21. Në një datë të pacaktuar, parashtruesi parashtrroi ankesë në Gjykatën e Apelit të Kosovës duke pretenduar, *inter alia*, se Gjykata Themelore ka bërë shkelje esenciale të procedurës penale dhe vlerësim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike. Parashtruesi kryesisht u ankua se Policia e Kosovës ka kurdisur që ai të pranojë para nga X, që X ka pranuar se ai ka bërë një gabim të fakteve dhe të ligjit (*lajthim faktik dhe juridik*), dhe se, dënimi me burgim dhe gjobë është i rëndë duke marrë parasysh gjendjen familjare të parashtruesit.
22. Më 21 nëntor 2014, Gjykata e Apelit e Kosovës, me Aktgjykimin PAKR. Nr. 473/2014, e refuzoi ankesën e parashtruesit si të pabazuar dhe vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore.
23. Në pjesën relevante të Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit theksohet:

"Duke i vlerësuar këto prova dhe fakte kjo Gjykatë gjen se pretendimet në ankesë sa i përket gjendjes faktike nuk mund të pranohen si të tilla. Në radhë të parë i dëmtuari vet e ka paraqitur rastin në polici, pastaj dëshmia e tij e dhënë në polici dhe në Prokurori korrespondon me dëshmitë e zyrtarëve policor dhe provat tjera materiale CD e incizuar, listingun e thirrjeve/Sms hyrëse-dalëse, prandaj pretendimi se dëshmia e të dëmtuarit në shqyrtimin gjyqësor është reale, se i dëmtuari ishte në lajthim faktik dhe se rasti është sajuar përjashtohet tërësisht. Se cilën deklaratë do ta aprovojë gjykata ajo nuk është e lidhur as e kufizuar me rregulla të posaçme formale provuese. Në parim mbështetet ajo deklaratë që ka mbështetje në provat tjera. Prandaj, kjo Gjykatë vlerëson se konkludimi i Gjykatës së shkallës së parë se në veprimet e të pandehurit qëndrojnë elementet e veprës penale, nga neni 428 par.2 të KPK për të cilën është akuzuar dhe shpall fajtor është i drejtë. Sipas përkufizimit ligjor të dispozitës së lartcekur kjo veprë penale ekziston atëherë kur personi zyrtar në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të

tërthortë, kërkon ose pranon ndonjë dhuratë apo përfitim të tillë, në mënyrë që personi zyrtar të veprojë ose të mos veprojë, në kundërshtim me detyrën e tij zyrtare. Këto forma të veprimit të kryerjes së kësaj vepre penale personi zyrtar i ndërmerr për të vepruar në kundërshtim me detyrën e tij zyrtare, pra bëhet fjalë për veprim të palejueshëm, të paligjshëm të personit zyrtar. Ndërsa, meqë është vërtetuar se i pandehuri të dëmtuarit i kërkoj dhe i mori para për të mos e dërguar njehsorin elektrik në Qendrën e Kalibrimit, kjo gjykatë vlerëson se tek veprimet e tij janë përmbushur elementet e veprës penale të marrjes së ryshfetit nga neni 428 par.2 të KPRK, ngase ai ka marrë para që të veprojë në kundërshtim me detyrën e tij zyrtare, pra, të ndërmarrë veprimin e kundërligjshëm. Ndërsa, qëndron fakti se gjykata nuk e ka llogaritur kohën e kaluar në paraburgim në dënimin e shqiptuar, mirëpo, në rastin konkret kemi të bëjmë me një lëshim thjesht teknik ngase siç del nga shkresat e lëndës dhe aktgjykimi i kundërshtuar koha e kaluar në arrest shtëpiak të pandehurit i është llogaritur nga dita e caktimit të paraburgimit. I pandehuri ka qëndruar në paraburgim prej 3.08.2013 deri më 2.09.2013, ndërsa në dënimin e shqiptuar gjykata ia ka llogaritur kohën e kaluar në arrest shtëpiak prej 3.08.2013 deri me 21.10.2013. Për, këto arsye kjo Gjykatë i vlerësoj si të pabazuara edhe pretendimet ankimore sa i përket shkeljes se ligjit penal”.

Ligji

Pjesa përkatëse e Kodit Penal të Republikës së Kosovës, parashihen si më poshtë:

Neni 428 Marrja e ryshfetit

1. Personi zyrtar i cili në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, kërkon ose pranon ndonjë dhuratë apo përfitim tjetër për vete apo personin tjetër, ose që pranon ofertën apo premtimin për dhuratë apo përfitim të tillë, në mënyrë që personi zyrtar të veprojë ose të mos veprojë në pajtim me detyrën e tij zyrtare, dënohet me gjobë dhe me burgim prej 6 (gjashtë) muaj deri në 5 (pesë) vjet.

2. Personi zyrtar i cili në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, kërkon ose pranon ndonjë dhuratë apo përfitim tjetër për vete apo personin tjetër, ose që pranon ofertën apo premtimin për dhuratë apo përfitim të tillë, në mënyrë që personi zyrtar të veprojë ose të mos veprojë, në kundërshtim me detyrën e tij zyrtare, dënohet me gjobë dhe me burgim prej 3 (tre) deri në 12 (dymbëdhjetë) vjet.

3. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni rezulton me përfitim në vlerë që tejkalon 15.000 (pesëmbëdhjetë mijë) euro, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim prej 1 (një) deri në 8 (tetë) vjet.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

24. Parashtruesi i kërkesës pretendon shkeljen e neneve 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 33 [Parimi i Legalitetit dhe

Proporcionalitetit në Rastet Penale], 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (1) dhe 3 (d) të Konventës dhe nenin 7 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: DUDNJ).

25. Parashtruesi i kërkesës pretendon se *“ai ishte futur në grackë dhe se rasti i tij ishte një kurdisje nga Policia e Kosovës për shkak se ai kishte pranuar paratë për të paguar borxhin dhe jo si ryshfet, dhe se, rastisi që X të jetë mik i policit hetues”*.
26. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata e Apelit - në seancën kryesore - nuk ka marrë parasysh se X ka deklaruar se ai ia kishte dhënë të hollat për të paguar borxhin dhe jo si ryshfet, se X ka kërkuar publikisht falje nga parashtruesi i kërkesës, dhe se, X nuk ka parashtruar kërkesë për kompensimin e dëmit (*kërkesë pasurore-juridike*) nga parashtruesi i kërkesës.
27. Parashtruesi i kërkesës pretendon se gjykatat e rregullta kanë shkelur parimin e barazisë së armëve, sepse as ai dhe as avokati i tij nuk janë njoftuar kur prokurori e ka marrë në pyetje X, se gjykatat e rregullta nuk i kanë vlerësuar deklaratat e tij, por vetëm ato të Prokurorisë dhe Policisë së Kosovës, dhe për më tepër, gjykatat e rregullta nuk e kanë vërtetuar si duhet faktin se ai nuk ishte një person zyrtar, por më tepër një elektrikist që ofron shërbime për punëdhënësin e tij.
28. Parashtruesi i kërkesës pretendon se kohëzgjatja e tij e burgimit është shumë e lartë dhe jo në proporcion me aktakuzën, sepse në raste të ngjashme gjykatat e rregullta kanë dhënë dënime më pak të ashpra.
29. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata: (i) ta deklarojë kërkesën e tij të pranueshme, (ii) të konstatojë shkelje të neneve 21, 24, 31, 33, 54 të Kushtetutës, nenit 7 të DUDNJ dhe nenit 6 të Konventës dhe (iii) të përcaktojë ndonjë të drejtë apo përgjegjësi për palët në këtë kërkesë të cilat kjo Gjykatë e nderuar i konsideron ligjrisht të bazuara dhe të arsyetuara.

Pranueshmëria e kërkesës

30. Gjykata së pari vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuar më tej në Ligj dhe në Rregulloret të punës.
31. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili parasheh:
“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.
32. Gjykata i referohet edhe nenit 48 të Ligjit, i cili parasheh:
“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

33. Gjykata, më tej, merr parasysh rregullin 36 (1) (d) dhe 2 (b) të Rregullores së punës, i cili saktëson:

“(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:

...

(d) kërkesa nuk arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.

(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:

...

(b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese”.

34. Sa i përket pretendimit të futjes në grackë nga Policia e Kosovës, Gjykata konsideron se çështje me rëndësi është nëse Policia e Kosovës mund të konsiderohet se iu ka “bashkëngjitur” apo “infiltruar” në veprimtarinë kriminale e jo se ta ketë iniciuar atë. Në rastin konkret, edhe pse Policia e Kosovës kishte ndikuar në rrjedhën e ngjarjeve, sidomos duke i dhënë kartëmonedhat personit privat X, veprimet e saj duhet të trajtohen si të “bashkëngjitura” veprimtarisë kriminale e jo se ta ketë iniciuar atë, pasi iniciativa në këtë rast ishte marrë nga personi privat X. Ky i fundit ishte ankuar në Policinë e Kosovës se parashtruesi i kërkesës do të kërkonte ryshfet për të arritur një rezultat të favorshëm në rastin e tij, dhe vetëm pas kësaj ankese Policia e Kosovës kishte hyrë në veprim. (Shih rasti *Miliniene kundër Lituaniës*, kërkesa nr. 74355/01, GJEDNJ, Aktgjykim i 24 qershorit 2008).
35. Sa i përket pretendimit të parashtruesit të kërkesës se nuk ishte njoftuar kur X është marrë në pyetje nga Prokurori, Gjykata vëren se nuk ka asgjë në kërkesë që tregon se kjo çështje është ngritur nga parashtruesi i kërkesës gjatë rrjedhës së procedurës së rregullt. Kjo çështje është ngritur për herë të parë në Gjykatën Kushtetuese. Megjithatë, Gjykata Kushtetuese - në pajtim me parimin e subsidiaritetit - nuk mund ta vlerësojë këtë çështje pa qenë paraprakisht e ngritur dhe vlerësuar në procedurë të rregullt.
36. Sa i përket pretendimeve në lidhje me vlerësimin e provave gjegjësisht cilave dëshmi duhet t’u jepet më shumë peshë dhe përparësi, sjellja e dëshmitarit X *post factum* dhe ashpërsia e dënimit janë të gjitha çështje të faktit dhe ligjit që bien nën kompetencat e gjykatave të rregullta. Në të vërtetë, në bazë të Kushtetutës sonë, është detyrë dhe prerogativë e gjykatave të rregullta që të vërtetojnë çështjet e faktit dhe të ligjit. Përveç kësaj, Gjykata vëren se nuk ka asgjë në këtë kërkesë që do të tregonte se prova është marrë në mënyrë të paligjshme ose në kundërshtim me dispozitat kushtetuese.
37. Në fund, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës vetëm numëron dhe në përgjithësi përshkruan përmbajtjen e dispozitave kushtetuese pa dëshmuar saktësisht, se si janë shkelur ato dispozita në rastin e tij siç kërkohet me nenin 48 të Ligjit.
38. Gjykata thekson se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të merret me gabimet e faktit ose të ligjit që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta

gjatë vlerësimit të provave apo zbatimit të ligjit (ligjshmëria), përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura nga Kushtetuta (kushtetutshmëria).

39. Në të vërtetë, është roli i gjykatave të rregullta që të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih, *mutatis mutandis*, *Garcia Ruiz kundër Spanjës [DHM]*, Nr. 30544/96, para. 28, Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut [GJEDNJ] 1999-I).
40. Gjykata Kushtetuese rikujton se nuk është gjykatë e gjetjes së fakteve dhe se vërtetimi i drejtë dhe i plotë i gjendjes faktike është juridiksion i plotë i gjykatave të rregullta, ndërsa roli i Gjykatës Kushtetuese është vetëm që të sigurojë pajtueshmërinë me të drejtat që garantohen me Kushtetutë dhe instrumente të tjera ligjore, prandaj, nuk mund të veprojë si “gjykatë e shkallës së katërt” (Shih, rastin *Akdivar kundër Turqisë*, Nr. 21893/93, GJEDNJ, Aktgjykimi i 16 shtatorit 1996, para. 65, po ashtu *mutatis mutandis* në Rastin KI86/11, parashtues i kërkesës *Milaim Berisha*, Aktvendim për papranueshmëri, i 5 prillit 2012).
41. Gjykata thekson se detyrë e saj është të vërtetojë nëse procedurat në gjykatat e rregullta ishin të drejta në tërësi, duke përfshirë edhe mënyrën e marrjes së provave (Shih, rastin *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Nr. 13071/87, Raport i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut, i 10 korrikut 1991).
42. Në këto rrethana, Gjykata konsideron se parashtuesi i kërkesës nuk e ka mbështetur me prova pretendimin e tij për shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut të garantuara me Kushtetutë, Konventë apo DUDNJ, sepse faktet e paraqitura nga ai në asnjë mënyrë nuk tregojnë që Gjykata e Apelit të Kosovës ia kishte mohuar atij të drejtat e garantuara me Kushtetutë.
43. Rrjedhimisht, kërkesa është qartazi e pabazuar dhe duhet të deklarohet e papranueshme në pajtim me rregullin 36 (2) (b) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 48 të Ligjit dhe me rregullin 36 (2) (b) të Rregullores së punës, më 28 janar 2015, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese



Snezhana Botusharova



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese



Arta Rama-Hajrizi